

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit nr. 03 / L-040, nenit 62 të Statutit të Komunës, thërras:
Mbledhjen e Komitetit për Komunitete për dt.24.05.2022, (e martë) në ora 10:00 me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Informatë nga Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë lidhur me problemin e dobët të energjisë elektrike në Plemetin
4. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

(Signature)
Avdyl Mustafa



Nr. 170 Data 18.05.2022
Br. 170 Datum 18.05.2022



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq – Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për komunitete, të mbajtur me dt.27.04.2022 në ora 11:00 në sallën e takimeve.
Të pranishëm ishin këta anëtarë: Avdyl Mustafa, Florije Jashari, Lulzim Preniqi, Faton Beka, Haki Abazi, Sanela Mackic, Predrag Micalovic dhe Valbonë Beka
Të pranishmit tjerë: Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf. e OSBE-së dhe përf.e OJQ-së “Ec Ma Ndryshe”
Mbledhjen e udhëhoqi Avdyl Mustafa, i cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit vjetor të punës të Komitetit për komunitete për vitin 2022
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit vjetor të Komitetit për komunitete për vitin 2021
5. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës i cili u miratua njëzëri nga të pranishmit.

Pika 1 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju njoftoj se znj.Katarina Adjancic, ka dhënë dorëheqje dhe ajo natyrisht dorëheqjen do ta bëjë te kryesuesja e Kuvendit dhe do të shqyrtohet mundësia e zëvendësimit të saj.Ndërsa të gjithë anëtarët tjerë janë të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesi – Dua, të ju njoftoj se të gjitha rekomandimet që i kemi marrë ia kam adresuar kryesues së Kuvendit, por nuk kemi marrë përgjigje me shkrim, përveq përgjigjeve me gojë ku na u tha se ID-të janë vetëm për anëtarë të Kuvendit komunal. Po ashtu, edhe disa propozime që i kemi pasë fatkeqësisht nuk janë aprovuar.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ne e kemi formuar Komisionin prej 3 anëtarësh lidhur me planin vjetor të punës të Komitetit për komunitete për vitin 2022 dhe hapi debat nëse, dikush ka për të thënë diçka.

Sanela Mackic - Unë kisha me shtue diçka, pasi e pashë se deri më tash nuk është përfshirë në planin vjetor të punës të Komitetit, që të përfshihen edhe njerëzit nga komuniteti boshnjak, që ta festojnë edhe ata ditën e boshnjakëve 28 shtatorin. Pra, nëse kjo mund ti shtohet planit pastaj ne mund të planifikojmë disa aktivitete për atë ditë.

Anëtarët e Komitetit për komunitete e aprovuan Planin vjetor të punës të Komitetit për komunitete për vitin 2022, me plotësimin e cekur më lartë.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Po ashtu, e dini se ne e kemi formuar edhe prej 3 anëtarëve për raportin vjetor të Komitetit për komunitetet dhe nëse, ju nuk keni diçka me shtue, do të ju informoj se siq e dini edhe ju në vitin e kaluar u mbajtën zgjedhjet dhe ne si Komitet kemi mbajtur 11 mbledhje. Ne më së shumti kemi shqyrtuar për gjendjen shëndetësore, fillimin e vaksinimit ku jemi kyqë me Drejtorinë e shëndetësisë që sa më shumë ti informojmë qytetarët lidhur me vaksinimin. Ne kemi diskutuar edhe për gjendjen e infrastrukturës në Komunën e Obiliqit dhe i kemi dhënë disa propozime dhe rekomandime. Fatkeqësisht, nuk kemi përgjegje konkrete, por e di se kanë punuar diçka në Komunën e Obiliqit, ku janë të kyqura komunitetet pakicë. Ju, e dini se kemi kërkuar një përkthyes dhe një procesmbajtës, por deri më tani asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Po ashtu, kemi kërkuar të na rregullohen kartelat nga kryesuesja e Kuvendit të na përgjegjet me shkrim se cila është arsyeja që ne nuk mund ti marrim kartelat. Në fund kemi kërkuar të rregullohet edhe sistemi i nxemjes në sezonën e dimrit sepse ju e dini se për arsye të mungesës së nxemjes nuk kemi mund ti mbajmë takimet e rregullta.

Faton Beka – Dua të shtoj diçka te rekomandimet e bashkangjitura në raport, të cilat ia kemi procedue edhe Kuvendit komunal, por përgjegje qoftë gojore apo me shkrim nuk na është kthyer, do të thotë nuk është aprovuar pothuajse asnjë rekomandim. Unë e di se ndoshta Komuna, nuk i ka të gjitha mund është financiare dhe ligjore me i përkrahë të gjitha ato rekomandime, por të paktën janë disa rekomandime që mundën me u bë sa i përket kartelave. Po ashtu, edhe me shtue stafin profesional siq e kemi cekë një përkthyes dhe një procesmbajtës, këtë e kemi kërkuar pothuajse qdo vit, por asnjëherë nuk na është dhënë ndonjë përgjegje se a mundën, apo nuk mundën. Mendoj se kishte me qenë mirë dhe duhet që ky raport me kalie edhe në Kuvend sepse Kuvendi është i njoftuar për punën tonë dhe rekomandimet e cekura është mirë me i marrë parasysh, të paktën me na dhënë një përgjigje se disa kanë zgjidhje dhe nuk kushtojnë ku me ditë sa. Këto rekomandime ne i kemi cekë edhe më heret dhe pothuajse janë të njëjtat në raport t ë punës.

Kryesuesi – Ne raportin vjetor do të ia dërgojmë kryesueses së Kuvendit, ashtu siq kemi bërë edhe vitin e kaluar, por në këtë vit prapë do të kërkoj përgjegje me shkrim për të gjitha rekomandimet që i kemi marrë deri më tani duke përfshirë edhe raportin.

Pas kësaj, kryesuesi e hudhi në votim raportin vjetor të Komitetit për komunitete për vitin 2021 i cili u aprovua unanimisht.

Pika 5 e rendit të ditës

Sanela Mackic – Unë nuk e di se a duhet ti drejtohem ZKKK-së, apo kujt për të kërkuar listën e familjeve boshnjake në territorin e Komunës së Obiliqit. Fatkeqësisht, unë nuk i njohë të gjithë, por në periudhën e ardhshme kisha dashur ti vizitoj dhe mundësisht ti barti nevojat e tyre sepse mendoj se ata kanë disa nevoja për të cilat ne mund të iu ndihmojmë. Prandaj, e kërkoj listën e atyre familjeve, nëse mund ta marrë.

Kryesuesi – Ne do të bëjmë përpjekje bashkë me ZKKK-në, që mundësisht ta marrim atë listë.


Haki Abazi – Fillimisht dua të ua uroj 8 prillin, Ditën ndërkombëtare të komunitetit rom dhe unë po ndjehem keq edhe pse nuk jam pjesë e komunitetit rom, por 8 prilli nuk është shenuar në Komunën e Obiliqit si festë zyrtare e komunitetit rom. Neve, qdo herë na kanë përkrahë për këto festa sepse ne e kemi një herë në vit ndërsa, shteti si shtet ka shumë festa dhe mbahen, që besoj se edhe neve duhet pak me na respektue për festat që i kemi një herë në vit. Arsyeja dhe shkaqet nuk po dihen pse nuk është përkrahë dita ndërkombëtare e romëve, por besoj se në të ardhmen jo vetëm dita ndërkombëtare e romëve, por edhe ditët tjera të komunitetit që shenohen duhet të respektohen dhe sa do pak të iu ofrohen mundësitë për ditët tona që besoj se është mirë edhe për shtetin tonë të shenohen këto ditë. Besoj se nuk do të ketë më këso gabime, ose lëshime, duhet me na respektue të gjithëve pa dallim

Kryesuesi -Të falenderoj z.Haki, dhe ashtu është se 8 prilli është dita nacionale e romëve dhe ne si komunitet e kemi dorëzuar një kërkesë në Komunë, te Kryetari por nuk kemi pasë përgjegje. Arsyen unë nuk e di, por me këto gjëra mund të merremi më vonë. Unë e falënderoj Nënkryetarin e Komunës, që ia dha mundësinë një organizate që para Komunës, ta vendosë e flamurit si shenjë e ditës

nacionale të romëve dhe ai flamur ka qëndruar një ditë para Komunës.Ndoshta, nuk kanë pasë mund ësi të na përgjegjen në kërkesat tona, por do të shohim.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50'

Procesmbajtëse


Azize Zeneli

Kryesuesi i Komitetit per komunitete


Avdyl Mustafa

